

Nr. 02/24

Datë: 22.07.2024

Prishtinë

*Në mbështetje të nenit 9 pika 2 dhe të nenit 106 pika 1 të Statutit të Fakultetit të Studimeve Islame (në tekstin e mëtejme FSI), në mbështetje të vendimit nr. 112/23 të Këshillit Mësimor Shkencor të FSI-së, si dhe në mbështetje të vendimit nr. 741/24 të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, FSI miratoi këtë:*

## **RREGULLORE PËR STUDIMET MASTER**

### **Neni 1 Qëllimi**

Me këtë rregullore përcaktohen kriteret për organizimin e studimeve master, kushtet e regjistrimit në studime, kushtet e regjistrimit të vitit, kohëzgjatja e studimeve, ndërrimi i programit të studimeve, procedura e propozimit dhe mbrojtjes së punimit të diplomës së master-it, si dhe çështjet tjera të rëndësishme për studimet master në Fakultetin e Studimeve Islame (në tekstin e mëtejme FSI).

### **Neni 2 Organizimi dhe kohëzgjatja e studimeve Master**

1. FSI organizon studime të rregullta të nivelit master shkencor.
2. FSI mund të organizojë programe të nivelit master në partneritet me universitetet tjera bazuar në marrëveshjet për bashkëpunim.
3. Programet në studimet master duhet të jenë në harmoni me nevojat e zhvillimit shkencor, profesional, kulturor, dhe nevojat e Bashkësisë Islame të Kosovës, si dhe në harmoni me kërkesat e tregut të punës.
4. Programi i studimeve, organizimi i mësimit, përpilimi i syllabusëve, si dhe mënyra e mësimdhënies dhe mësim nxënies duhet të jenë në harmoni me sistemin e Bolonjës.
5. Dekanati inicion propozimet për programe të reja të studimit në koordinim me themeluesin, duke respektuar procedurat e brendshme të Fakultetit dhe standardet e aplikueshme të akreditimit.

6. KMSH jep miratimin përfundimtar për propozimin dhe hapjen e programeve të reja, duke vazhduar me procedurat e tjera për plotësimin e kërkesave ligjore të parapara nga AKA.
7. Studimet e nivelit master, varësisht nga programi i studimit, zgjasin 2 (dy) semestra, me gjithsej 60 ECTS kredi të akumuluar; 4 (katër) semestra, me gjithsej 120 ECTS kredi të akumuluar.
8. Me përfundimin e suksesshëm të studimeve master fitohet thirrja akademike: master i shkencës apo master i arteve.
9. Studenti ruan statusin e studentit të rregullt në kohëzgjatjen sa dyfishi i kohëzgjatjes së studimeve të rregullta, duke kryer obligimet e parapara sipas kërkesave të programit përkatës dhe Statutit të FSI-së. (Respektivisht 2 vite akademik).
10. Studenti mund të kërkojë një herë që t'i vazhdohet kohëzgjatja e studimeve për gjashtë muaj, vendim të cilin e merr KMSH në pajtim me Statutin e FSI-së.
11. Mësimi në studimet master zhvillohet për 15 javë, brenda një semestri (me mundësi zgjatjeje të këtij afati me ndonjë vendim të marrë nga KMSH për t'ju përshtatur specifikave të programeve përkatëse).

### **Neni 3** **Konkursi, kriteret për aplikim dhe përzgjedhja e kandidateve**

1. Këshilli Mësimor Shkencor e propozon numrin dhe kushtet specifike për regjistrimin e studentëve të rinj, sipas kërkesave të dekanatit për programet e akredituara dhe kuotës së lejuar nga Agjencia e Akreditimit.
2. Vendimin për shpalljen e konkursit publik e merr KMSH i Fakultetit.
3. Në studimet e nivelit master kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet themelore islame me së paku 240 ECTS kredi për studime master me 60 ECTS, ose njërën nga medresetë e mesme.
4. Për shkak të përmbajtjeve të programeve, dekanati mund të parashtrijë kriteret përkatëse/provime diferenciale në lidhje me të drejtën e regjistrimit për studentë që vijnë nga programe studimore të ndryshme nga fusha e studimit ku ata aplikojnë.
5. Të gjithë kandidatët që nuk kanë kryer studimet themelore përkatëse i nënshtrohen provimeve plotësuese në lëndët e përcaktuara nga KMSH. Provimet plotësuese përcaktohen nga komisioni profesional sipas fushës së studimit, dhe është i përbërë nga 5 anëtarë. Komisionin profesional e përzgjedh Këshilli i Fakultetit. Provimeve deferenciale kandidatët ju nënshtrohen para provimit pranues.
6. Në studimet e nivelit master kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit.
7. Në studimet master kanë të drejtë të aplikojnë edhe kandidatët të cilët studimet themelore i kanë kryer jashtë vendit, diplomat e të cilëve janë njohur (nostrifikuar) nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në bazë të ligjit dhe rregulloreve në fuqi.
8. Përzgjedhja e kandidatëve bëhet sipas kriterëve të përcaktuara me Statutin e FSI-së dhe sipas kushteve të përcaktuara në programin e akredituar dhe të cilat paraqiten në konkurs.
9. Përzgjedhjen e kandidatëve, bazuar në kriteret e përcaktuara me konkurs, e bën Komisioni përkatës, i përbërë nga të paktën tre (3) anëtarë nga radha e mësimdhënësve, të cilin e emëron Këshilli i Fakultetit.

10. Këshilli i Fakultetit e cakton një Komision të Ankesave *ad hoc* për shqyrtimin e ankesave të kandidatëve.
11. Kandidatët që nuk pranohen në studimet e nivelit master mund të bëjnë ankesë me shkrim në shërbimin administrativ të fakultetit, duke ia drejtuar ankesën Komisionit të Ankesave të Fakultetit, ankesa mund të parashtrohet në afatin kohor dy ditë pune pas publikimit të rezultatit. Komisioni për ankesa përpilon raport lidhur me ankesat e kandidatëve në afatin kohor brenda dy ditëve. Këshilli i Fakultetit shqyrton raportin e Komisionit të ankesave dhe merr vendim përkatës.
12. Afatet kohore të aplikimit, parashtrimit dhe shqyrtimit të ankesave, si dhe shpalljes së rezultateve preliminare dhe përfundimtare përcaktohen me Konkurs.

#### Neni 4

#### Regjistrimi në studime

1. Regjistrimi i studentëve në semestrin e parë të studimeve master bëhet në Administratën e Fakultetit, kurse pajisja e studentit me ID - kartelë bëhet nga shërbimi i IT-së në fakultet pas verifikimit nga ana e shërbimit të studentëve për studimet master në nivel të fakultetit.
2. Studimet master përfundojnë me dhënien e të gjitha provimeve, si dhe me mbrojtjen publike të punimit, me ç'rast studenti merr diplomën me numrin e ECTS-ve, varësisht nga programi i studimit (120 ECTS ose 60 ECTS).

#### Neni 5

#### Mësimi në studimet Master

1. Mësimi në studimet master realizohet në formë të ligjëratave, seminareve, ushtrimeve, punës praktike, punës në terren, vizitave studimore, diskutimeve, konsultimeve profesionale dhe nëpërmjet punimeve të pavarura të studentëve.
2. Të drejtën e mësimdhënies në studimet master e ka personeli mësimor me thirrjet universitare sipas Ligjit të Arsimit dhe Statutit të FSI-së: profesor i rregullt, profesor i asocuar, profesor asistent. Në raste të veçanta fakultetet mund të angazhojnë edhe profesor vizitor dhe bashkëpunëtor të jashtëm sipas rregulloreve përkatëse.
3. Asistentët angazhohen në procesin e mësimdhënies përmes mbajtjes së ushtrimeve, seminareve, diskutimeve, këshillimeve etj. Asistenti nuk mund të jetë bartës i lëndës në nivelin master dhe as të mbajë ligjëratë.
4. Në raste të caktuara kur për ndonjë lëndë mësimore mund të mbajnë mësim dy a më shumë mësimdhënës, notat në SIMS i evidenton bartësi i lëndës.
5. Fillimi dhe mbarimi i semestrave bëhet sipas dispozitave të Statutit të Fakultetit.

### **Neni 6 Ndërrimi i programit / i drejtimit të studimeve**

Për ndërrimin e programit të studimit ose për transferimin e studentit prej ndonjë Fakulteti tjetër, ose prej ndonjë Universiteti tjetër të akredituar brenda apo jashtë vendit, vlejné dispozitat e parapara me Statutin e FSI-së.

### **Neni 7 Kushtet e regjistrimit të vitit**

KMSH i Fakultetit me vendim të veçantë përcakton kushtet e regjistrimit të vitit vijues të studimeve.

### **Neni 8 Organizimi i provimeve dhe vlerësimi i suksesit**

1. Studenti fiton të drejtën t'i nënshtrohet provimit në një lëndë pasi t'i kryejë obligimet që parashihen me programin mësimor të studimeve master, dhe duke respektuar orarin e provimeve të shpallur nga Fakulteti.
2. Provimet në studimet master mbahen gjatë vitit akademik sipas afateve të publikuara/miratuara nga Fakulteti mbështetur në Statutin e FSI-së.
3. Mënyrat e organizimit të provimit mund të jenë: teorike/praktike/ performuese dhe e cila mund të jetë test ose pyetje e përgjigje me gojë.
4. Për vlerësimin e suksesit në provim të studentit mund të aplikohen edhe metoda tjera të vlerësimit, të përcaktuara në syllabuset e lëndëve përkatëse dhe në specifikat e programit të akredituar.
5. Për suksesin e arritur në provim, duke përfshirë edhe vlerësimin e punimit të diplomës studentit vlerësohet me notat numerike si në vijim: 10 dhe 9 – shkëlqyeshëm (A dhe B); 8 – shumë mirë (c); 7 – mirë (D); 6 – mjaftueshëm (E). Ndërsa nota numerike 5 – pamjaftueshëm (F) tregon se studentit nuk ka arritur ta kalojë provimin.
6. Nota e provimit evidentohet nga profesori në SIMS dhe Raporti në formën fizike dërgohet tek shërbimi për studentët sipas rregullores për funksionimin e SIMS-it.
7. Për studentët e pakënaqur me vlerësimin dhe notën e marrë në provim vlejné dispozitat e Rregullores për Studime dhe të Statutit të FSI-së.

### **Neni 9 Kërkesa për miratim të projekt propozimit dhe caktimi i mentorit**

1. Punimi i diplomës master është aktivitet shkencor/artistik i studentit me të cilin duhet të dëshmohet se studentit gjatë kohës së studimeve ka fituar kompetenca sipas programit të studimit.
2. Studenti mund të parashtrijë kërkesë për miratimin e projekt propozimit të punimit të diplomës master pasi të ketë përfunduar të gjitha obligimet e parapara nga programi i studimit, respektivisht, për studentet e programeve të studimeve me 60 ECTS semestri i parë të gjitha provimet e përfunduara, ndërsa për studentët e programeve të studimeve master me 120 ECTS të kenë të përfunduar të gjitha provimet e semestrave të vitit të parë të studimeve.

3. Në programet e studimit në të cilat lëndët janë një (1) vjeçare (jo semestrale), kushtet për fillimin e procedurave për miratimin e projekt propozimit, i cakton Këshilli i Fakultetit, bazuar në programin e akredituar.
4. Forma e kërkesës për miratimin e projekt propozimit të punimit të diplomës është e njëjtë dhe ajo merret në shërbime të studentëve ose në web faqe të fakultetit.
5. Kërkesa për miratimin e temës master bëhet me shkrim. Pjesë integrale e kërkesës duhet të jetë edhe projekt propozimi për temën, i cili duhet të përmbaj këto elemente:
  - 5.1. Arsyetimin e temës së propozuar,
  - 5.2. Qëllimin e studimit dhe objektivat,
  - 5.3. Përmbledhjen e literaturës së shqyrtuar,
  - 5.4. Pyetjen e hulumtimit dhe hipotezën/at,
  - 5.5. Metodologjinë e hulumtimit,
  - 5.6. Rezultatet e pritura të hulumtimit,
  - 5.7. Listën e referencave të literaturës së shqyrtuar.
6. Elementet sipas pikës 5, mund të strukturohen sipas specifikave të fushave të ndryshme dhe mund të precizohen me tutje nga njësia akademike, me udhëzues/vendim përkatës të miratuar në këshillin e fakultetit.
7. Kërkesa e kompletuar dhe e nënshkruar nga kandidati dhe nga mësimdhënësi me të cilin kandidati është konsultuar (e i cili mund të jetë kandidat potencial për mentor), protokollohet dhe dorëzohet te përgjegjësi për studime master.
8. Mentor i punimit të diplomës mund të jetë secili mësimdhënësi i cili plotëson kriteret sipas nenit pesë (5) të kësaj rregulloreje, nga fusha e temës se propozuar. Në raste te caktuara dhe sipas nevojës, mentor mund të jetë edhe një mësimdhënësi jashtë FSI-së i cili i plotëson kriteret e njëjta, mirëpo me këtë rast duhet të propozohet edhe një bashkëmentor brenda FSI-së, i cili do të ngarkohet me përgjegjësitë administrative dhe procedurale deri në mbrojtje të punimit të diplomës.
9. Punimi i diplomës master është punim individual.

### Neni 10

#### **Shqyrtimi i kërkesës dhe formimi i komisionit për vlerësim të punimit /dorëshkrimit dhe për mbrojtje të punimit të diplomës master**

1. Përgjegjësi për studime master, në bashkëpunim me mentorin, në afat prej 15 ditësh, shqyrton kërkesën e studentit lidhur me projekt propozimin e punimit të diplomës master.
2. Përgjegjësi për studime master, pas shqyrtimit të projekt propozimit të punimit master ka të drejtë ta refuzoj propozimin, ta kthejë për plotësim tek kandidati, apo ta aprovoj dhe t'i propozoj Këshillit të fakultetit miratimin e projekt propozimit dhe emërimin e mentorit.
3. Në rast të aprovimit, përgjegjësi e propozon edhe komisionin prej 3 anëtarëve për vlerësim të punimit (dorëshkrimit) dhe mbrojtje të punimit të diplomës master. Se paku dy (2) nga tre (3) anëtarët duhet të jenë nga fusha e temës se propozuar. Mentori caktohet anëtar por nuk mund të jetë kryetar i Komisionit për vlerësim dhe/apo mbrojtje të punimit të diplomës master. Kryetari i komisionit duhet të jetë nga profesorët e brendshëm.
4. Në rast se përgjegjësi propozon plotësimin e projekt propozimit, atëherë dinamikën e ndryshimit e cakton përgjegjësi.

5. Në rast të refuzimit të projekt propozimit, atëherë përfundon procesi i trajtimit të kërkesës dhe kandidati udhëzohet të parashtoj kërkesë dhe projekt propozim të ri për punimin e diplomës master.
6. KMSH në mbledhjen e radhës, por jo më vonë se 30 ditë pasi ka pranuar kërkesën e përgjegjësit, shqyrton propozimin e përgjegjësit për miratimin e projekt propozimit të punimit të diplomës master si dhe propozimin për emërimin e komisionit për vlerësimin e punimit të masterit dhe mbrojtje të punimit të diplomës.
7. KMSH mund ta miratoj propozimin e përgjegjësit apo ta kthej në rishqyrtim me arsyetim tek përgjegjësi, duke e obliguar përgjegjësin dhe mentorin ta rishqyrtoj në afat kohor prej 15 ditësh.

### **Neni 11** **Kërkesa për vlerësim të dorëshkrimit/punimit të dorëzuar të diplomës master**

1. Të paktën tre muaj pas datës së vendimit të KMSH për miratimin e projekt propozimit të punimit të diplomës master, kandidati, me pëlqimin paraprak të mentorit, mund të paraqes kërkesë për vlerësim pranë komisionit për vlerësim të punimit (dorëshkrimit/aktivitetit) lidhur me diplomën master.
2. Kërkesa për vlerësim të punimit nga ana e komisionit i dërgohet përgjegjësit për studime master përmes e-mailit zyrtar. Së bashku me kërkesën për shqyrtim dërgohet edhe raporti i mentorit i cili potencon se punimi i kandidatit ka përmbushur kriteret për të vazhduar në procedurë të vlerësimit nga ana e komisionit.
3. Komisionit, përmes e-mailit zyrtar, i dorëzohet kopja elektronike e dorëshkrimit/punimit/ të kandidatit. Sipas kërkesës së anëtarëve të komisionit mund të dorëzohet edhe kopja fizike.
4. Vërejtjet e komisionit përcillen përmes përgjegjësit për studime master deri te kandidati. Pas përmirësimit të vërejtjeve nga ana e kandidatit, komisioni, pas verifikimit të përmirësimeve, përmes një raporti elektronik i cili i dërgohet përgjegjësit për studime master konstaton se punimi ka përmbushur kriteret e nevojshme për mbrojtje.
5. Afati për vlerësimin e temës nga anëtarët e komisionit maksimalisht është një muaj.
6. Shtypja e punimit final të diplomës master duhet të bëhet në një anë të fletës A4. Punimi duhet të jetë i shkruar duke përdorur fontin *Times New Roman*, me madhësi të shkronjave 12. Hapësira mes rreshtash duhet të jetë 1.5 në të gjithë dokumentin. Duhet të respektohet udhëzimi në shkrim dhe strukturim të punimit të diplomës.
7. Pasi të pranoj kërkesën dhe kopjet e temës nga përgjegjësi i studimeve, mentorin, në bashkëpunim me komisionin, brenda 15 ditësh përgatitë raportin e vlerësimit të dorëshkrimit të punimit master, sipas formularit, i cili, i nënshkruar dhe i protokoluar i dorëzohet shërbimit të studentëve të Fakultetit.
8. Një kopje e raportit ruhet në dosjen e kandidatit.
9. Këshilli i Fakultetit mund të lejojë që studentit – shtetas i huaj, që punimin e masterit ta dorëzojë dhe mbrojë në gjuhën arabe, boshnjake dhe atë angleze, në rastet e veçanta.
10. Punimi i masterit dorëzohet në shtatë (7) kopje, lidhje e fortë, kopertinat ngjyrë vishnje.



## Neni 12

### **Raporti i vlerësimit të dorëshkrimit ose aktivitetit artistik, diskutimi publik dhe procedura për mbrojtje publike**

1. Pasi komisioni paraqet raportin pozitiv për vlerësim të dorëshkrimit të punimit të diplomës master, mund të vazhdohet me procedurën e diskutimit publik dhe mbrojtjes së temës së diplomës master.
2. Në rast se komisioni ka dhënë vërejtje dhe ka propozuar plotësimin e dorëshkrimit, kandidati duhet të bëjë korrigjimet e nevojshme brenda 30 ditësh, nga dita e pranimit të vërejtjeve dhe sugjerimeve të komisionit.
3. Në rast të raportit pozitiv, ekzemplari i punimit, së bashku me raportin e komisionit qëndrojnë në diskutim publik 7 ditë. Njoftimi se punimi është në diskutim publik, dhe një abstrakt i zgjeruar i punimit deri në tre (3) faqe, publikohet në web faqe të fakultetit.
4. Pas mbylljes së diskutimit publik dhe shqyrtimit të rekomandimeve nga diskutimi, nëse raporti është i nënshkruar nga tre (3) anëtarët, dhe nuk ka pas ndonjë çështje substanciale kontestuese gjatë fazës së diskutimit publik, pas konsultimit dhe pëlqimit të komisionit, zyrtari përgjegjës administrativ i shërbimit master përmes një konfirmimi me shkrim konstaton se janë përmbushur të gjitha kushtet dhe janë respektuar procedurat e parapara me këtë rregullore dhe aktet tjera në fuqi për mbrojtje të punimit të diplomës master. Konfirmimi me shkrim i dërgohet sekretarit të fakultetit, dekanit të fakultetit dhe anëtarëve të komisionit.
5. Në qoftë se punimi i kandidatit refuzohet nga Komisioni për vlerësimin e punimit, ose kandidati për shkaqe të tjera nuk e bën plotësimin e punimit sipas rekomandimeve të komisionit dhe në afatet e caktuara, kandidati ka të drejtë që të paraqesë propozim me shkrim për titullin e ri të punimit të masterit. Këtë mundësi kandidati mund ta shfrytëzojë vetëm një herë.

## Neni 13

### **Procedura paraprake dhe mbrojtja e punimit**

1. Mbrojtja publike e punimit të diplomës master (prezantimi publik i aktivitetit) duhet të bëhet brenda një afati jo më pak se 8 ditë dhe jo më shumë se 30 ditë nga dita e nxjerrjes së vendimit për mbrojtje të punimit.
2. Në rast se kandidati nuk e përfundon punimin e diplomës më së largu 1 (një) vit nga data kur është lejuar tema nga KMSH, kandidati mund të paraqesë kërkesë për vazhdimin e punimit të temës në periudhën shtesë prej 6 muajsh.
3. Në rast se kandidati nuk e përfundon punimin e temës së diplomës edhe pas vazhdimin të lejuar 6 muaj nga Këshilli i Fakultetit, konsiderohet se punimi nuk është rezultuar i suksesshëm dhe kandidati obligohet të paraqesë propozim të ri me mentor të ri.
4. Përgjegjësi për studime në koordinim me komisionin dhe administratën e fakultetit dhe në marrëveshje me kandidatin cakton datën dhe vendin (sallën) e mbrojtjes publike të punimit.
5. Administrata e fakultetit në konsultim me komisionin e mbrojtjes, shpall lajmërimin për mbrojtjen e punimit të diplomës master së paku 5 ditë para ditës së mbrojtjes.
6. Lajmërimi shpallet në tabelën e shpalljeve në Fakultet dhe në ueb-faqen e Fakultetit. Në lajmërim jepen të dhënat për kandidatin, tema e punimit, data, ora dhe salla e mbrojtjes publike.

7. Mbrojtjen publike e udhëheq kryetari i komisionit.
8. Mentori e lexon raportin e komisionit dhe, sipas nevojës, në pika të shkurtra e paraqet biografinë e kandidatit i cili mbron temën.
9. Kandidati bënë një prezantim – paraqitje të përmbledhur të punimit, mundet edhe përmes sllajdeve, por jo më gjatë se 20 minuta. Anëtarët e komisionit përmes pyetjeve që ia shtrojnë kandidatit dhe përgjigjeve të tij, e bëjnë verifikimin e autorësisë të punimit dhe vlerësojnë nivelin e njohjes së problematikës që trajtohet në punim
10. Notën e punimit të diplomës master e vendos mentori në SIMS, bazuar në procesverbalin e mbrojtjes së punimit të diplomës të nënshkruar nga anëtarët e komisionit.
11. Komisioni për mbrojtje të punimit të masterit e bën vlerësimin menjëherë pas mbrojtjes publike të punimit të masterit.
12. Shërbimi i studentëve master përgatit procesverbal për mbrojtjen publike të temës së masterit, të cilin e nënshkruajnë anëtarët e komisionit dhe sekretari i fakultetit.
13. Dekani, nënshkruan vendimin për mbrojtjen publike.
14. Në rastet kur punimi për shkaqe objektive nuk mbrohet me sukses, mbrojtja publike duhet të përsëritet brenda afatit 3 mujor.
15. Në situata të jashtëzakonshme, me vendim paraprak të dekanit, mbrojtja e temës master mund të bëhet edhe nga distanca, përmes video komunikimit. Kjo përfshinë edhe pjesëmarrjen e ndonjërit nga anëtarët e komisionit në mbrojtjen publike.

#### **Neni 14 Diplomimi**

1. Studimet master përfundojnë sipas afateve të përcaktuara me dispozitat e Statutit të FSI-së.
2. Kandidati ka mbrojtur me sukses punimin e diplomës master në qoftë se vendimi dhe vlerësimi pozitiv i mbrojtjes së punimit janë bërë njëzëri ose nga shumica e anëtarëve të Komisionit.
3. Kandidati që e mbron me sukses punimin e diplomës i lëshohet diploma sipas dispozitave të parapara në programin e akredituar dhe dispozitat e tjera statutare.
4. Kandidati që e mbron me sukses punimin e diplomës i lëshohet diploma me numër të ECTS në varësi të programit të studimit.
5. Një abstrakt i zgjeruar i punimit të diplomës deri në 3 faqe e punimit, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze, publikohet në ueb faqen e fakultetit më së largu një javë pas mbrojtjes publike dhe fitimit të titullit.

#### **Neni 15 Ruajtja e integritetit akademik**

1. Kandidati secilit version të dorëzuar të punimit të diplomës duhet t'ia bashkëngjisë deklaratën e studentit mbi autenticitetin e punimit të miratuar nga KMSH, me të cilën me përgjegjësi etike deklaron se punimi është punuar nga kandidati dhe nuk është rezultat i veprimeve jo etike.
2. Kandidati, mentori, komisioni vlerësues dhe instancat tjera përgjegjëse duhet të përkujdesen për ruajtjen e integritetit akademik dhe shmangien nga praktikat jo etike në të gjitha fazat e përgatitjes dhe vlerësimit të punimit të diplomës master.



3. Punimit të dorëzuar me shkrim të masterit, kandidati duhet t'ia bashkëngjis edhe raportin e nxjerrë nga softueri përkatës antiplagjiaturë.
4. Paragrafi 3 fillon të zbatohet nga momenti kur fakulteti siguron qasje zyrtare në softuerin përkatës antiplagjiaturë për studentë dhe staf.
5. Nëse pas mbrojtjes së punimit të masterit, respektivisht promovimit, paraqitet dyshimi që punimi nuk është punë vetjake e kandidatit, KMSH emëron Komisionin tre anëtarësh i cili e hulumton bazën e dyshimit nëse kandidati është autor i punimit të magistraturës në tërësi. Në Komisionin e pikës së mësipërme nuk mund të emërohen mësimdhënësit para të cilëve punimi i magistraturës është mbrojtur.

### **Neni 16 Kontestimi dhe revokimi/marrja e thirrjes Master**

1. Kandidatit mund t'i kontestohet dhe t'i merret grada master nëse konstatohet se punimi i diplomës master është plagjiaturë, fabrikim ose falsifikim.
2. Dyshimet për praktikën e plagjiaturës dhe praktikën e tjera jo etike në punimin e diplomës master mund të ngriten nga secili person brenda dhe jashtë Fakultetit.
3. Në rast dyshimi të bazuar, përgjegjësi për studime master i propozon KMSH-së përbërjen e Komisionit prej tre anëtarësh që të shqyrtojë dyshimet e paraqitura. Në Komision nuk mund të emërohen mësimdhënësit para të cilëve punimi i masterit është mbrojtur.
4. Komisioni i ngritur nga KMSH i paraqet Këshillit raportin përfundimtar me përfundim të qartë dhe të argumentuar. KMSH e shqyrton raportin e Komisionit dhe, nëse konstaton dyshimet nga paragrafët e mësipërm të këtij neni, i propozon Këshillit të Fakultetit marrjen e thirrjes së masterit.
5. Këshilli Mësimor Shkencor e merr vendimin përfundimtar për marrjen e thirrjes së masterit.

### **Neni 17 Përfundimi/shuarja/mbyllja e programit Master**

1. Programet e studimeve master mund të përmbillen në rastet si në vijim:
  - 1.1. Me propozim të dekanatit të fakultetit, si dhe me aprovim të Këshillit;
  - 1.2. Mos-aplikimi për riakreditim bazuar në propozimin e departamentit;
  - 1.3. Dështimi i fitimit të riakreditimit;
  - 1.4. Rënia e numrit të përcaktuar të stafit akademik si persona përgjegjës të programeve të akredituara;
  - 1.5. Mos-plotësimi i kushteve tjera të përcaktuara nga Agjencia për Akreditim e Kosovës (AKA).
2. Në rast të mbylljes së programeve të studimeve master, fakulteti vazhdon të përcjellë gjeneratat e studentëve të regjistruar në atë/ato programe deri në diplomim ose deri në afatet e përcaktuara për diplomim sipas Statutit të FSI-së ose vendimeve të Këshillit.
3. Studentët që diplomojnë në këto programe kanë të gjitha të drejtat që i takojnë me fitimin e titullit të përcaktuar me ato programe.

### **Neni 18** **Udhëzuesit dhe dokumentet tjera përcjellëse**

1. Krahas rregullores, Fakulteti mund të hartojë edhe dokumentet në vijim:
  - 1.1. Udhëzuesit për projekt propozim;
  - 1.2. Udhëzuesit për vlerësimin e punimit final të masterit dhe prezantimit të tij (një formular i përbashkët për komisionin);
  - 1.3. Udhëzuesit dhe dokumentet tjera të cilat nuk bien ndesh me këtë rregullore dhe ndihmojnë në avancimin e cilësisë së studimeve master.
2. Udhëzuesit dhe dokumentet e tjera përcjellëse në këtë nen miratohen në Këshill të Fakultetit.

### **Neni 19** **Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e Miratimit në Këshillin e Fakultetit dhe aprovimit nga ana e Kryesisë së BIK-ut.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për studimet master, me nr. prot. 03/12, datë 13.12.2012.
3. Procedurat e parapara me këtë rregullore aplikohen edhe për temat e diplomës master që janë iniciuar apo miratuar dhe që janë në proces në ndonjërin nga fazat e përgatitjes apo mbrojtjes së tyre.

Për të gjitha çështjet e tjera që nuk janë përfshirë në këtë Rregullore do të zbatohen dispozitat e ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës.

**Prishtinë,**

**DEKANI**



**22.07.2024**

**Prof. asoc. dr. Islam Hasani**


REPUBLIKA E KOSOVËS  
BASHKËSIA ISLAME E KOSOVËS  
Kryesia  
REPUBLIC OF KOSOVA  
ISLAMIC COMMUNITY OF KOSOVA  
The Presidency



جمهورية كوسوفا  
الاتحاد الإسلامي في كوسوفا  
رئاسة الاتحاد

Nr. 741/24 Data: 22.07.2024

رقم: \_\_\_\_\_  
التاريخ: \_\_\_\_\_



Në bazë të nenit 45.1.23, të Kushtetutës së Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës dhe nenit 106, paragrafi 3 të Statutit të Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë, Kryesia e Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 18.07.2024, pas shqyrtimit të Draft - Rregullores për studime MA në FSI në Prishtinë, mori këtë

## V E N D I M

1. Miratohet Rregullorja për studime MA në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë.
2. Rregullorja për studime MA në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e kryetarit të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës.
3. Me këtë Vendim njoftohet Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë dhe një kopje ruhet në arkivin e kësaj Kryesie.



**KRYETARI**  
Myftiu: Naim ef. Tërnavë